



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.197/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli Komuna Graçanicë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lista Serbe, me seli në Komuna e Mitrovicës së Veriut për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. **PRANOHET E BAZUAR** ankesa e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli Komuna Graçanicë, ZL. Anr.197/2025 datë 11.10.2025.

II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Komuna e Mitrovicës së Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00 Euro (dymijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Komuna e Mitrovicës së Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi të largojë billbordin e vendosur në objektin banesor kolektiv në rrugën që çon në vendin kryesor të votimit në Leposaviq, përndryshe mosbindja ndaj kësaj urdhërese paraqet shkelje tjetër të këtij ligji që mund të sanksionohet me dënime shtesë nga PZAP-i.

A r s y e t i m

Me datë 11.10.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, në të cilën pretendohet se aktivistët e tyre më 11.10.2025, duke mbikëqyrur aktivitetet e subjekteve të tjera politike, vunë re se në territorin e komunës së Leposaviqit (qendra e komunës) ende qëndron një billbord i madh në një vend të paautorizuar (ndërtesë) në rrugën që çon drejt vendit kryesor të votimit, i cili ndodhet në më pak se 100 metra.

Parashtruesi i ankesës thekson se më 08.10.2025 u miratua një vendim nga PZAP kundër subjektit politik "Lista Serbe", me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilin është urdhëruar që

nga momenti i marrjes së këtij vendimi të heqë posterin e vendosur në një ndërtesë banimi në rrugën që çon në vendin kryesor të votimit në Leposaviq, dhe deri më sot ata nuk e kanë bërë këtë dhe iu janë shmangur urdhrat të PZAP-it, gjë që është në kundërshtim me kodekset ligjore të subjekteve politike, duke përdorur objekte për promovim dhe duke shkelur rregullat e fushatës zgjedhore.

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja ka ndodhur më 11.10.2025 në orën 14:00.

Kërkojnë nga PZAP të miratojë ankesën si të bazuar dhe të ndëshkohet subjekti politik "Lista Serbe" - Zlatan Elek, në përputhje me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, më datë 11.10.2025, i dërgoi kërkesë për përgjigje në ankesën, mirëpo subjekti politik Lista Serbe, deri në afatin e paraparë më datë 12.10.2025, në ora 14:00 nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se :

-Ankesa është e bazuar.

Paneli me vendimin e tij ZLAnr 104/2025 të datës 08.10.2025 e ka Pranuar të bazuar ankesën e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Komuna Graçanicë, ndërsa Subjektit Politik Lista Serbe, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i ka shqiptuar dënimin më gjobë në lartësi prej 1,000.00 (njëmijë) Euro, dhe e ka detyruar të njëjtën që gjobën e shqiptuar ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi si dhe e ka urdhëruar që nga momenti i marrjes së vendimit, ta largoj posterin e vendosur në objektin banesor kolektiv që çon në vendin të votimit në Leposaviq.

Në ankesën e ZLAnr. 197/2025 të datës 11.10.2025 subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, thekson se subjekti politik Srpska Lista, nuk e ka larguar billbord dhe se i njëjti po vijon me shkeljen përsëritëse në të cilin ka vendosur në ndërtesë kolektive në rrugën që çon drejt vendit kryesor të votimit, në Leposaviq.

Paneli, pas shikimit të bërë fotografisë së ofruar si provë materiale e cila është bashkangjitur në ankesë është vërtetuar se billbordi i vendosur në fjalë ende ekziston, për promovimin e subjektit politik Lista Serbe.

Përdorimi i një objektit kolektiv banesor për vendosjen e billbordit për qëllime elektorale është në kundërshtim me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se *“Veprimet e ndaluara të Subjekteve Politike...Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli vlerëson se në rastin konkret subjekti politik Lista Serbe përkundër vendimit të formës së prerë të PZAP-it, ZL.A.nr.104/2025 datë 08.10.2025, nuk i është përmbajtur detyrimit që të largoj posterin nga objekti kolektiv, andaj bazuar në këtë vendim të PZAP-it, subjekti ne fjalë i shqiptohet dënimi shtesë, sipas nenit 120, par.2 të LZP, *“ Dështimi për të paguar*

dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-së brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-ja”.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 dhe 120 paragrafi 2 i LZP-së, dhe nenit 13 paragrafi 10 i Rregullës Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.197/2025 më datë 13.10.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa bazuar në nenin 118 paragrafi 4 të LZP-së.*